

SHPIRTI KRIJUES KOSOVAR

Robert Elsie

Me datën 1. Mai 1995 në ambientet e *Haus Feldmaus*-it në malësinë e Ajfel-it të Gjermanisë, u hap një ekspozitë e veprave artistike të skulptorit shqiptar **Agim Çavdarbasha**. Albanologu Dr. Robert Elsie ishte aty:

Shekulli ynë po merr fund dhe një popull evropian lufton për të mbijetuar. Ky popull, afërsisht me dy miljon shqiptarë të Kosovës në ish-Jugosllavi, jeton nën pushtimin ushtarak pa gëzuar asnjë të drejtë të njeriut dhe të qytetarit. Spastrimi etnik në Kosovë, pjesa nën zgjedhë e Jugosllavisë së re, tashmë ka arritur përmasa kërcënuese. Në shënjestër të kësaj politike të parët janë intelektualët, shkrimtarët dhe artistët shqiptarë, d.m.th. krijuesit të cilët paraqesin një rrëzik për përandorinë serbomadhe. Prandaj, gëzohemi edhe më tepër kur shohim se shpirti krijues kosovar lulëzon me gjithë kushtet e vështira.

Kosova, fusha legjendare e mëllenjave, në jug të Gadishullit Ballkanik, merr kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Për shumicën e banorëve të saj Kosova është e vetëshpallur Republika e Kosovës e pushtuar nga jashtë, një vend nën zgjedhën brutale të Serbisë, një vend i cili kërkon lirinë dhe demokracinë, një vend i cili qysh prej kohësh ka qenë etnikisht shqiptar. Ndërsa për pakicën e saj të vogël serbe, Kosova është Serbia e Vjetër, djepi i kulturës ortodokse serbe, e pushtuar nga hordhitë islame. Për të gjithë banorët e saj, Kosova është fuçia e barotit të Ballkanit, një vend pasionesh.

Shqiptarët dhe sllavët jetojnë bashkë në Kosovë qysh prej shekujsh. Megjithëse kurrë nuk kanë patur marrëdhënie të ngushta, ka patur edhe kohë të qeta në historinë e tyre të përbashkët, gjatë të cilave kanë jetuar në paq dhe mirëkuptim me njëri tjetrin. Por, më shpesh marrëdhëniet kanë qenë të acaruar. Qysh prej marrjes së pushtetit në Kosovë nga Serbia në vitin 1989, kundër vullnetit të qartë të shqiptarëve, të cilët përbëjnë afërsisht 90% të popullsisë, gjëndja është bërë eksplozive.

Ndërhyrja e ushtrisë serbe në Kosovë në verë të vitit 1990 çoi vendin në prag të një lufte civile të përgjakur. Parlamenti i zgjedhur dhe qeveria u nxorën në rrugë. E vetmja gazetë e përditshme shqiptare Rilindja si dhe radio dhe televizioni u ndaluan. Qysh prej kësaj kohe, masa të dhunshme e famëkeqe kanë mundur jo vetëm pushimin e të gjithë udhëheqësve shqiptarë, por edhe afërsisht të 200,000 punëtorëve të shumicës shqiptare. Në vjeshtë të vitit 1991, mësimi në Universitetin e Prishtinës u ndërpre, me përjashtim të ligjeratave për pakicën e vogël serbe. Gjithashtu u mbyllën shkollat fillore dhe të mesme nga pushtetmbajtësit. Prej tri vitesh, profesorët shqiptarë nuk lejohen të venë këmbë në universitet, mjekët dhe infermierët nuk futen më në spital. Jeta kulturore publike u pezullua qëllimisht nga pushtetmbajtësit. Askund në Evropë s'janë shkelur në mënyrë aq flagrante dhe aq sistematike të drejtat e njeriut si në Kosovë.

Agim Çavdarbasha është me siguri skulptori më i njohur i këtij vendi. Mund të thuhet bile se ai është ndër skulptorët kryesorë të kombit shqiptar. Lindur në Pejë më 24 mars 1944, artisti u diplomua në vitin 1969 në Akademinë e Arteve Aplikative në Beograd. Në vitin 1971 u diplomua në studimet pasuniversitare të Akademisë së Arteve Figurative në Lubjanë. Gjatë qëndrimit të tij disavjeçar në Beograd dhe veçanërisht në Lubjanë u njoh mirë me rrymat e artit jugosllav dhe ato të Evropës qendrore.

Megjithëkëtë, vepra artistike e Agim Çavdarbashës është e lidhur ngushtë me vendlindjen e tij, Kosovën. Ai është jo vetëm skulptor por edhe pedagog në Universitetin e Prishtinës, tashmë i 'privatizuar' nga pushteti serb. Agimi takohet me studentët e tij jo më në

godinën e pushtuar ushtarakisht të universitetit, por në mjediset private ose tek ai në atelie, ku artistët e rinj vijnë të admirojnë parkun e tij të skulpturave.

Unë desha të shfrytëzoj këtë rast të përmend dy ngjarje nga karrjera e Agim Çavdarbashës. Para afërsisht pesëmbëdhjetë vjetësh, Agimi u ngarkua me punë të krijojë një kompleks figurash për muzeun e Lidhjes së Prizrenit, të njohur nga gjithë shqiptarët në të dyja anët e kufirit. Ky kompleks figurash, i cili përfaqëson baballarët e kombit dhe vetëdijen kombëtare të viteve 1878-1881, qëndron i paprekur - shpresoj - në oborrin e muzeut dhe është bërë vend pelerinazhi për shqiptarët. Agimi më tha se u kritikua rëndë nga shumë bashkatdhetarë të tij. Figurat u realizuan të vogla, në përmasa njerëzore dhe jo të mëdha, gjigante ashtu siç shqiptarët i përfytyrojnë trimat e kombit. Kosova u tut. Kam përshtypjen se artisti ka dashur t'i tregojë bashkatdhetarëve të tij se edhe njerëz më të vegjël mund të kryejnë vepra të mëdha.

Me gjithë kufirin eksistues i cili, ashtu si Muri i Berlinit, e ndan në mënyrë të prerë Kosovën nga Shqipëria, bashkohen ngadalë ngadalë gjashtë milion shqiptarët në Gadishullin Ballkanik. Kështu ndodhi kur në qershor të vitit 1993 u zhvillua në Tiranë për herë të parë Java Kulturore e Kosovës për t'i ofruar dheut amë diçka të re, të ndaluar deri në atë kohë, krijimet artistike të bashkatdhetarëve të tyre përtej kufirit. Ngjarja qëndrore e kësaj jave ishte një ekspozitë arti e zhvilluar në të ashtuquajturën Piramida, ish-muzeu i diktatorit Enver Hoxha, i cili shërben tash si qendër ndërkombëtare takimi. Qendra e vëmendjes në sallën e ekspozitës ishte pikërisht krijimtaria e Agim Çavdarbashës, skulpturat e mahnitshme prej druri dhe mermeri të rumbullakosura, të cilat gjetën pëlqimin jo vetëm të presidentit dhe të anëtarëve të qeverisë, por edhe të publikut të gjërë, gjë kjo shumë më e rëndësishme. Unë do të thoshja bile se kjo ekspozitë përbën një pikëkthesë në historinë e skulpturës shqiptare.

Tash Agim Çavdarbasha banon përkohësisht këtu në Gjermani, me ftesë të shtëpisë të Hajrih Bël-it në rrethin e Dyrën-it. Artisti jeton prej katër muajsh me në një atmosferë të qetë dhe frymëzuese, larg fantazmave të spastrimit etnik, larg pasigurisë dhe mjerimit të vendlindjes së tij të shumëvuajtur, pranë admiruesve të shumtë të artit të tij. Vepra të mëdha ka realizuar gjatë kësaj kohe skulptori shtatvogël por plot talent dhe modest, i cili kthehet në vendlindjen e tij të pasigurtë, pranë popullit të tij.

[Published in / botuar në: Zëri, Javore Politike Shqiptare, Prishtina, 13.05.1995, p. 64]